



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 3-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 22. 12. 2017 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Diamant Bytyqi, anëtar
3. Arton Retkoceri, anëtar
4. Mehmetali Krasniqi, anëtar
5. Nehat Tërpeza, anëtar
6. Fadil Sopa, anëtar
7. Hyra Bytyqi, anëtare
8. Linda Shahini, anëtare
9. Anila Reçica, anëtare
10. Ramadush Tasholli, anëtar
11. Naim Jahiri, anëtar
12. Majlinda Sylejmani, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Argjent Tasholli, anëtar
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
18. Egzona Bytyqi, anëtare
19. Selatin Retkoceri, anëtar
20. Shkelzen Bislimi, anëtar
21. Albulena Kelmendi, anëtare
22. Afrim Miftari, anëtar
23. Hajdin Bytyqi, anëtar
24. Safete Amerllahu, anëtare
25. Bashkim Budakova, anëtar
26. Ukë Kryeziu, anëtar
27. Ganimete Qeriqi, anëtare
28. Manush Shamolli, anëtar
29. Egzona Fazliu, anëtare
30. Arben Salihu, anëtar
31. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës në detyrë
3. Avni Olluri, drejtor i Administratës
4. Rasim Hasani, drejtor i DA
5. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
6. Adem Duriqi, drejtor i DP,
7. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP,
8. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
9. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
10. Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH
11. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
12. Emina Rexhiqi, drejtoreshë e DPU-së
13. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
14. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
15. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
16. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
17. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHR"
18. Ylber Reçica, OJQ "POLIS"
19. Përfaqësues të mediave dhe
20. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**.

Kryesuesi i Kuvedit Daut Azemi pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë të gjithë anëtarët e Kuvendit hapi mbledhjen dhe fillimisht përshëndeti Kryetarin e komunës, Nënkryetarin, drejtorët e drejtorateve si dhe asambleistët dhe të tjerët prezent.

Pastaj uroj Kryetarin Imri Ahmeti për ekipin e tij të ri dhe i uroj punë të mbarë.

Para se të kalojmë në rendin e ditës Kryesuesi propozoj që anëtarët e rinjë të Kuvendit Ramadush Tasholli, Naim Jahiri, Majlinda Sylejmani, Bashkim Budakova dhe Fehmi Rexhepi të japin betimin të gjithë së bashku duke lexuar deklaratën e betimit dhe kërkoj që deklaratën ta lexoj Majlinda Sylejmani e që në vazhdim të gjithë anëtarët dhanë betimin duke lexuar së bashku deklaratën e betimit.

Pastaj Kryesuesi tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar. Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime? Meqë askush nuk pati vërejtje as plotësime, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat për, miratoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-rë inauguruese e Kuvendit
2. Propozim Vendim për emërimin e Nënkryetarit për Komunitete
3. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
4. Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete
5. Propozim Vendim për themelimin e KKSB-së

6. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtëshme të Komunës së Lipjanit
7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave

Para se të kalohët në punë Kryesuesi pyeti anëtarët se a ka dikush pyetje parlamentare?

Linda Shahini, fillimisht më lejoni që të uroj ekzekutivin dhe punë të mbarë dhe njëkosisht përshëndes zgjedhjen e dy drejtoreshave gra dhe ky fakt më gëzon. Unë kisha me ngritë edhe një pyetje apo shqetësim lidhur me super marketet ku shumë prej tyre kanë produkte me afatë të skaduar dhe i ndryshojnë tiketat për t'u vazhduar afatet.

Lulzim Rrustemi, fillimisht përshëndeti të pranishmit uroj anëtarët e Kuvendit dhe punë të mbarë e gjithashtu urime edhe për ekzekutivin dhe besoj se është një ecje përpara me përfaqësimin e grave për dy pozitat për drejtoresha, por grupi parlamentar i PDK-së shprehë shqetësimin lidhur me zgjedhjen e këtij ekzekutivi për shkakun se brenda këtij ekzekutivi është edhe pozita e dytë e komunës për zgjedhjen e Nënkryetarit e cila ka shkelje ligjore dhe për këtë jini të informuar përmes mjeteve të informimit. Kam edhe një pyetje e do ta kërkoj edhe me shkrim dhe ne jemi të interesuar të dijmë për ekzekutivin se sa ka arritë me i paguar borxhet që ka deklaruar se janë 7 milion e gjithashtu sa borxhe janë të këtij mandati që e lam pas.

Argjent Tasholli, fillimisht përshëndeti të pranishmit pastaj tha se janë bërë dy lista për ndarje të serave dhe unë pyes Kryetarin e komunës se a ka mundësi se si ky komision që ka vendosur për dhënien e serave i njëjti komision duke u thirrë në shqyrtimin e ankesave të fermerëve heq 7 fermer nga lista pa i njoftuar fare dhe i njëjti komision publikon listën me emra të ndryshuar të fermerëve. A dihet se të dy listat janë të aprovuara nga Kryetari i komunës. Andaj pyes si është e mundur që i njëjti komision vlerëson listat e fermerëve dhe i njëjti merret me shqyrtimin e ankesave dhe bën ndryshimin e përfituesve të serave. Kryetar ne e dijmë se ndoshta të kanë votuar edhe njëzë që kanë vdekur para 4 viteve por të lutem korigjoj listat e ndarjes së serave se ka përfitues që ka vdek para 3 viteve.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, përshëndes të pranishmit dhe anëtarët e rinjë të Kuvendit të cilët dhanë betimin. Pastaj tha se po nisem nga kjo e fundit që përmendi Argjenti dhe ju them se kur është shpallë qështja e konkurimit për ndarjen e serave dihet se ka qenë me vones për 5-6 muaj për shkak të mos aprovimit të buxhetit e kjo ka shkaktuar vonesë jo vetëm për bujqit por edhe për sportistët. E dyta ju them ka pasur një ftesë të të gjitha partive të asaj kohe që kanë qenë në asamble komunale e që z. Tasholli nuk e din se nuk ka qenë në atë kohë dhe ftesa ka qenë zyrtare për të gjithë që të jenë prezent në komision për ndarjen e serave por nuk kanë marrë pjesë. Sa i përket komisionit për ndarjen e serrave nuk ka qenë vetëm një komision por ka qenë edhe komisioni për shqyrtimin e ankesave dhe komisioni ka shqyrtuar ankesat e fermerëve dhe i ka dhënë referencat për ndryshimin e ndarjes së serrave dhe në bazë të referencave komisioni për ndarjen e serave ka qenë i obliguar të zbaton ato referenca të komisionit për ankesa, çka do të thotë se nuk qëndron që e thotë Argjenti që komisioni për ndarje të serrave ka formuar 2 lista. Sa i përket pyetjes së Lulit për qështjet e borxhit është pyetje me vend dhe besoj se së shpejti do të merrni përgjigjjen për këtë. Sa i përket pyetjes së Lindës lidhur me skadimin e afateve të artikujve në super markete është me vend dhe drejtori i inspekcionit duhet të merrë masa të duhura për këtë qështje.

Meqë dikutime tjera nuk pati rreth pyetjeve parlamentare u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 1-rë inauguruese e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë

Arben Salihu, te prezenca mbiemri im është shënuar gabimisht Fazliu dhe kërkoj që të përmirësohet dhe të bëhet Salihu. Meqë vërejtje tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së parë inauguruese me vërejtjen e Arben Salihut dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi unanimisht

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 1-rë inauguruese e Kuvendit me vërejtjen e Arben Salihut

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Vendim për emërimin e Nënkyetarit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi i dha fjalën Kryetarit të Komunës Imri Ahmeti i cili në vazhdim propozoi Lulzim Qerimi për Nënkyetarë të Komunës për Komunitete.

Pastaj Kryesuesi hapi shqyrtimin?

Lulzim Rrustemi, na grupi parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim me që është në përputhëshmëri me Ligj.

Diamant Bytyqi, fillimish përshëndeti të pranishmit dhe anëtarët e rinjë që dhanë betimin e pastaj tha se na si grup parlamentar i LDK-së e përkrahim propozimin e Kryetarit për Nënkyetarin e Komunës për Komunitete.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e Kryetarit për zgjedhjen e Nënkyetarit të Komunës për Komunitete dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për aprovoi propozimin dhe nxori këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

Neni 1

Emërimi

Lulzim Qerimi nga Magura me përgaditje profesionale superiore – Drejtimi Administratë Publike, nga komuniteti jo shumicë ashkali, **emërohet** Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Përgjegjësitë

1. Nënkyetari i Komunës për Komunitete e ndihmon Kryetarin në kryerjen e detyrave të tij,
2. Ofron këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë,
3. Mbështet dhe afirmon kërkesat e komuniteteve jo shumicë në organet e Komunës.

Neni 3

Mandati

Mandati i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete është i njëjtë me atë Kryetarit të Komunës.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

III

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi tha se sipas llogarisë që kemi bërë edhe me KKZ-në në bazë të përqindjes të përfaqësimit në Kuvend të subjekteve politike në Komiteti për Politikë dhe Financa struktura e Komitetit duhet të jetë si vijon: LDK- 3 anëtarë, PDK- 1, LVV-1, AAK-1 dhe AKR- 1. Harrova të ju them se sipas udhëzimit të ri administrativ KPF-ja duhet të ketë 7 anëtarë. Në vazhdim tha se në këtë mandat në Kuvend kemi një anëtar të Komunitetit pakicë dhe unë propozoj që te LDK-ja të hiqet një anëtar të mbetën vetëm 2 ndërsa nga Komuniteti PAI të caktohet një anëtar. Ky propozim u përka nga të pranishmit dhe Kryesuesi pyeti se kush ka propozime për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa duke shtuar se Kryesuesi i Komitetit është Kryesues i Kuvendit.

Diamant Bytyqi, nga LDK-ja propozoj Arton Retkocerin
Lumturije Bytyqi-Hasani, nga PDK-ja propozoj Lulzim Rustemin
Albulena Kelmendi, nga VV-ja propozoj Selatin Retkocerin
Bashkim Budakova, nga AAK-ja propozoj Ukë Kryeziun
Hajdin Bytyqi, nga AKR-ja propozoj Afrim Miftarin
Daut Azemi, nga PAI propozoj Fehmi Rexhepin.

Pastaj Kryesuesi theksoi se partitë që nuk u përfshinë në KPF do të përfshihen në Komitetin për Komunitete.

Egzona Fazlija, më vjenë keq që në KPF nuk u përfaqësu asnjë femër.

Lumturije Bytyqi-Hasani, është mirë që dikush me u djegë dhe me u përfshi një femër e në këtë rast i bjen LDK-së.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimet për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 4 kundër miratoi propozimet dhe nxori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Kryesuesi i Kuvendit është Kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 3

Komiteti për Politikë dhe Financa ka mandat 4 vjeçar

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa emërohen si vijon:

1. Daut Azemi, Kryesues i Komitetit

2. Arton Retkoceri, LDK
3. Lulzim Rustemi, PDK
4. Selatin Retkoceri, VV
5. Ukë Kryeziu, AAK
6. Afrim Miftari, AKR
7. Fehmi Rexhepi PAI

Neni 5

Komiteti për Politikë dhe Financa në pajtim me dispozitat e nenit 52 par.52.2 ka detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, Planin vjetor të prokurimit, Rregulloren vjetore për tatimet, tarifatat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim Vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi tha se ky Komitet do të ketë gjithsej 9 anëtarë dhe prej tyre 4 do të jenë nga partitë politike në Kuvend dhe 5 do të jenë nga komunitetet jo shumicë. “Nisma dhe partia e Drejtësisë” do të kenë nga një anëtarë në këtë Komitet meqë nuk u përfaqësuan në KPF, ndërsa LDK dhe PDK si parti më të mëdha në Kuvend do të kenë nga një anëtar. Në vazhdim lexoi propozimet e dërguara me shkrim nga komunitetet jo shumicë për anëtarët të Komitetit për Komunitete si vijon:

Nga komuniteti rom, është propozu Ferat Gashi

Nga komuniteti turk, Skender Bikliqi

Nga komuniteti kroat, Goleme Petar Franjo

Nga komuniteti serb, Boban Jovanoviq dhe

Nga komuniteti malazez, Zoran Qirkoviq

Pastaj pyeti se kush ka propozime për anëtarët tjer nga komuniteti shumicë.

Diamant Bytyqi, nga LDK, propozoj Naim Jahirin

Argjent Tasholli, nga PDK, propozoj Lumturije Bytyqi-Hasani

Manush Shamolli, nga Nisma, propozoj Egzona Fazlija dhe

Daut Azemi, nga PD, propozoj Arben Salihun.

Pastaj Kryesuesi Daut Azemi vuri në votim propozimet për anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 6 kundër, asnjë apstenim miratoi propozimet dhe nxori këtë:

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka mandat 4 vjeçar

Neni 3

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohen si vijon:

1. Naim Jahiri, anëtar, nga Kuvendi
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare, nga Kuvendi
3. Egzona Fazlija, anëtare, nga Kuvendi
4. Arben Salihu, anëtar, nga Kuvendi
5. Ferat Gashi, anëtar, nga Komuniteti rom
6. Skender Bikliqi, anëtar nga Komuniteti turk
7. Goleme Petar Franjo, nga Komuniteti kroat
8. Boban Jovanoviq, anëtar nga Komuniteti serb
9. Zoran Çirkoviq anëtar nga Komuniteti malazez

Neni 5

Komiteti për komunitete në pajtim me dispozitat e nenit 53 par.53.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në web-faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Propozim Vendim për themelimin e KKSB-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi i dha fjalën Nazim Gashit, drejtor i DBSH i cili në vazhdim lexoi propozimin e vendimit për themelimit e KKSB-së.

Pastaj Kryesuesi lexoi propozimet për anëtar të KKSB-së të cilat kanë ardhur me shkrim e duke shtuar se Kryesuesi i KKSB-së është Kryetari i Komunës Imri Ahmeti.

Pastaj hapi diskutimin lidhur me këtë nëse ka dikush të thotë diçka, nëse jo atëherë vej në votim propozimet për anëtarët e KKSB-së të cilët i lexuam më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për aprovoi propozimet për anëtar të KKSB-së dhe nxori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Lipjanit , (në vazhdim të tekstit KKSB), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës –Kryesues i KKSB-së
2. Driton Imeri, Komandant i Stacionit Policor,
3. Xhevdet Bytyqi, Bashkësia Islame
4. Srgjan Stankoviq, Kisha ortodokse
5. Don Mateje Paliq, Kisha katolike
6. _____ OJQ "POLIS" ,komuniteti shqiptar
7. Zoran Radiq , komuniteti serb
8. Alush Bikliqi, komuniteti turk
9. Imer Dibrani ,komuniteti ashkali
10. Maksut Gashi , komuniteti, rom
11. Hana Guciq, komuniteti kroat
12. _____, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete
13. Gjyste Dabaj, Zyra për barazi gjinore
14. Rasim Hasani, Drejtori i Drejtoratit për Arsim
15. Milazim Sadiku , Kryetar i Këshillit të prindërve
16. Kap. Fejzullah Fejzullahu nga FSK
17. Fehmi Gajtani, Këshilli Lokal për Siguri Publike,
18. Haqif Rrustemi, Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
19. Nazim Gashi, Drejtorati për Mbrojtje dhe Shpëtim
20. Radmilla Simijonoviq, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
21. Bekim Krasniqi, përfaqësues nga OJQ-të, mediat lokale, komuniteti i biznesit dhe komuniteti i personave me aftësi të kufizuara

Neni 2

Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës me të drejta dhe përgjegjësi të plota ashtu siq i ka Kryesuesi i KKSB-së.

Neni 3

Mandati i anëtarëve të KKSB-së është i njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Neni 4

Detyrat, përgjegjësitë , mbledhjet dhe çështjet tjera që lidhen me punën e KKSB-së janë të përcaktuara me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Neni 5

Për punën e tyre anëtarët e KKS-së paguhen nga buxheti Komunes. Kompensimi për anëtarët e KKS-së për pjesëmarrje në takime, bëhet me shumën ekuivalente të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kompensimi për pjesëmarrje në takimet e KKS-së bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunes.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi i dha fjalën Avni Olluri, drejtor i DA i cili në vazhdim njoftoi të pranishmit me propozim vendimin dhe strukturën e këtij komisioni.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit njoftoi të pranishmit me emra të anëtarëve të komisionit nga ekzekutivi të cilët i ka propozuar Kryetari i Komunes siqë janë:

Shkelzen Hajdini, drejtor i DEZH
Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU-se dhe
Ilir Tasholli, drejtor i SHP

Pastaj pyeti se kush ka propozime nga subjektet e përfaqësuese në Kuvend që duhet të propozojnë 3 anëtarë.

Diamant Bytyqi nga LDK, propozoj Linda Shahinin
Lulzim Rrustemi nga PDK, propozoj Ramiz Qeriqin
Selatin Retkoceri nga VV, propozoj Albulena Kelmendin dhe
Daut Azemi nga shoqëria civile propozoj Flakadan Osmanin.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimet për anëtarët e komisionit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për aprovoi propozimet dhe nxori këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME TË KOMUNES SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunes (në vazhdim të tekstit: Komisioni) në përbërje prej 7 (shtatë) anëtarëve, prej të cilëve tre anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunes nga përbërja e ekzekutivit të Komunes, tre anëtarë nga subjektet e përfaqësuese në Kuvendin e Komunes dhe një anëtar ekspert nga Shoqëria civile.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Shkelzen Hajdini, Kryesues i Komisionit Drejtor i Drejtoratit per EZH

2. Emina Rexhiq, anëtare, Drejtoreshë e Drejtoratit për Planifikim dhe Urbanizëm
3. Ilir Tasholli, anëtar, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike
4. Linda Shahini, anëtare, nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Komunës
5. Ramiz Qeriqi, anëtar nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Komunës
6. Albulena Kelmendi, anëtare, nga subjektet e përfaqësuara në Kuvendin e Komunës
7. Flakadon Osmani, anëtar, nga Shoqëria civile KVRL

Neni 2 Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3 Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit do të jetë deri përfundimin e mandatit të rregullt ligjor të anëtarëve të Kuvendit

Neni 4 Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin e Kuvendit të Komunës me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e neneve 8 dhe 9 Ligjit Nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe me dispozitat e neneve 5,6,7,8,9,10,13,14,15,16,17 dhe 18 të Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5 Detyrat për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme

Komisioni në pajtim të nenit paraprak të këtij Vendimi, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës ka për detyrë dhe kryen punët, si vijon:

Në pajtim të nenit 8 të Ligjit dhe nenit 7 të Rregullores së cekur, përgatitë dhe publikon Njoftimin për Ankand publik për dhënien afatshkurtër të pronës së caktuar të paluajtshme të

Komunës i cili duhet të publikohet në Webfaqen e Komunës në vendet publike dhe në mediat lokale, elektronike dhe të shkruara.

Në afat prej 7 dite pas skadimit të afatit për parashtrimin e ofertave sipas Ankandit bënë vlerësimin e ofertave në pajtim me kriteret ligjore dhe kriteret e Njoftimit për Ankand.

Konform nenit 6 të Rregullores së cekur bën përzgjedhjen e fituesit në bazë të çmimit më të lartë të ofruar në ankand publik.

Konform nenit 10 të Rregullores harton Raportin e vlerësimit të ofertave.

Konform nenit 10 par. 3 pas aprovimit të ofertës së përzgjedhur i dërgon Njoftimin fituesit dhe publikon këtë Njoftim në Webfaqen e Komunës dhe në Tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Njoftimi nga paragrafi paraprak duhet të përmbajë Udhëzimin juridik për të drejtën e pjesëmarrësve të ankandit për ankesë – Komisionit të ankesave në afat prej 15 dite nga dita e publikimit të Njoftimit..

Konform nenit 9 të Ligjit par. 6 dhe nenit 10 të Rregullores së cekur, pas skadimit të afatit për ankesa, nëse nuk ka patur ankesa ose ankesat nga Komisioni i ankesave janë vlerësuar si të pabazuara, ia dërgon Kryetarit të Komunës ofertën e përzgjedhur të fituesit në ankand bashkë me kopjen e Raportit për vlerësimin e ofertave për lidhje të Kontratës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së caktuar .

Neni 6

Detyrat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme

Komisioni në pajtim të nenit 4 të këtij Vendimi, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës ka për detyrë dhe kryen punët, si vijon:

Në pajtim të nenit 8 të Ligjit dhe nenit 7 të Rregullores së cekur, përgatitë dhe publikon Njoftimin për Konkurs publik për dhënien afatgjatë të pronës së caktuar të paluajtshme të Komunës , i cili duhet të publikohet në Webfaqen e Komunës, në vendet publike dhe në mediat lokale, elektronike dhe të shkruara.

Në afat prej 7 dite pas skadimit të afatit për parashtrimin e ofertave sipas konkursit, bënë vlerësimin e ofertave në pajtim me kriteret ligjore dhe kriteret e Njoftimit për konkurs.

Harton rekomandimin për përzgjedhjen e ofertës sipas kriterëve për përzgjedhjen e ofertave të përcaktuara në nenin 13 të Rregullores së cekur të cilin ia bashkëngjet Raportit përfundimtar për vlerësimin e ofertave.

Konform nenit 18 par. 4 të Rregullores harton Raportin përfundimtar mbi vlerësimin e ofertave të cilit ia bashkëngjet dokumentet e parapara me Rregullore.

Konform nenit 9 par.1 të Ligjit dhe neneve 15 par.3 , 18 par. 1 të Rregullores së cekur, brenda tri dite pune nga përfundimi i vlerësimit të ofertave, ia dërgon Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe rekomandon për ofertën e përzgjedhur.për të vendosur në procedurë të mëtejme në pajtim me Ligjin dhe rregulloren e cekur.

Neni 7

Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj,Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratet e Administratës Komunale.

Neni 8

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një ankandi – Konkursi, do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit të ankesave

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi i dha fjalën Avni Ollurit, drejtor i administratës i cili njoftoi me të dhënat nga propozimi i vendimit duke shtuar se Kryetari i Komunës për Kryesues dhe anëtarë të komisionit të ankesave ka propozu

Gafurr Hetemin për Kryesues, jurist nga zyra Pronoro Juridike
Rafete Retkocerin, anëtare, juriste nga DSHP dhe
Ilir Shala, anëtarë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim këtë propozim vendim dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, 3 kundër miratoi këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT TË ANKESAVE

Neni 1

Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

- 1.Gafurr Hetemi , Kryesues,
- 2.Rafete Retkoceri, anëtare
3. Ilir Shala, anëtar

Neni 2

Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Detyrat e Komisionit

Komisioni shqyrton ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës afatshkurtër dhe afatgjatë në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe në pajtim me dispozitat e

Rregullores nr.23/2013 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës .
Komisioni për ankesa bën shqyrtimin e ankesave brenda afatit prej 30 ditësh.

Neni 4
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj, Rregulloren e cekur dhe me këtë vendim do ti ndihmojë Zyra Kryetarit të Komunës - Sektori pronësor - juridik.

Neni 5
Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për shqyrtimin e të gjitha ankesave që kanë të bëjnë me procedurën e zbatimit të një ankandi përkatësisht një konkursi, do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11,²⁰

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi